



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 70/16
Prishtinë, më 19.10.2016, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Shqipe Pantina, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontić dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Bexheti - Kryesues i Bordit në RTK dhe Adelina Valla-Hyesni - Udhëheqëse Financiare në RTK.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Sahit Troshupa nga RTV- 21, Fjolla Uka - monitoruese nga KDI, Etleva Moloshi- Asistente, Florina Ejupi - monitoruese nga BIRN, Albulena Nuha - gazetare nga RTV- 21, Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 28.9.2016 dhe 7.10.2016;**
3. **Shqyrtimi i Raportit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-shtator 2016 dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën tetor-dhjetor 2016;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa dhe amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - propozoj që rendi i ditës të plotësohet me tri pika të reja, si në vijim: Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017-2019, në bazë të Qarkores së dytë buxhetore të

Ministrisë së Financave 2017/02. Shqyrtim i Raportit me rekomandime të Grupit Punues për Projektligjin Nr.05/L-100 për ndihmën shtetërore dhe Shqyrtim i Raportit me rekomandime të Grupit Punues për Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168.

Pas votimit, Komisioni vendosi që rendi i ditës të plotësohet me dy pika të reja 5 dhe 6, si në vijim: Shqyrtim i Raportit me rekomandime të Grupit Punues për Projektligjin Nr.05/L-100 për ndihmën shtetërore dhe Shqyrtim i Raportit me rekomandime të Grupit Punues për Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168. Ndërsa, pika e tretë Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017-2019, në bazë të Qarkores së dytë buxhetore të Ministrisë së Financave 2017/02, shtyhet për mbledhjen e radhës së komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 28.9.2016; dhe 7.10.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbalet nga mbledhja e komisionit dt. 28.9.2016 dhe 7.10.2016, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-shtator 2016 dhe Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën tetor-dhjetor 2016

Kryetari - theksoi në pajtim me Ligjin e Buxhetit, RTK e ka dërguar në Kuvend raportin financiar për periudhën janar-shtator 2016 dhe programin e shpenzimeve të planifikuara për periudhën tetor të dhjetorë 2016. Në jemi ngarkuar që të shqyrtojmë programin e shpenzimet dhe ti rekomandojmë Ministrisë së Financave.

Ismet Bexheti - ne kemi dërguar në Kuvend raportin financiar dhe programin e shpenzimeve siç kërkohet me Ligjin e Buxhetit. Në bazë të planit të veprimit ne kemi ndjekur një politikë të kursimeve, duke u munduar të ruajm përmbajtjen e programit. Por duke marrë parasysh nivelin e të hyrave që nuk përmbushin nevojat tona, por edhe borxhet e trashëguara, e rëndojnë buxhetin e RTK-së.

Kryetari- ne shpenzimet e juaja sidomos të pozicionit e paga e mallra e shërbimeve ka tejkalim. Pyetja ime është logjike ku i keni marrë paratë që keni bërë këto shpenzime, 101.24% për paga e mëditje është mbi atë që është lejuar edhe të kërkim mallrat e shërbimeve ka tejkalim 4.31% ndërsa në total keni bërë shpenzime 0.3% përtej asaj nëse kjo domethënë sqarohet unë jam në rregull me raportin e shpenzimeve.

Adelina Valla-Hyesni - në bazë të të dhënave në raportin për periudhën janar-shtator tejkalimet janë 8.24%, për dallim prej vitit 2015 që ka qenë 14.79%. RTK ka realizuar më tepër të hyra se sa që ka qenë të parapara.

Kryetari - vetëm sqaroje shpenzimet e bëra, ku i keni pas 4,950,000 euro për paga e mëditje, ndërsa shpenzimet janë 5 milion 11,133 euro. A ka rritje të të punësuarve apo rritja të pagesave apo çka ka ndodhur që është bërë ky tejkalim?

Adelina Valla-Hyesni – sqarojë se gjatë vitit kontratat mbi vepër është dasht me u shëndrru në kontrata të rregullta dhe kjo ka ndikuar tek shpenzimet për paga apo për tejkalimet në këtë kategori. Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 743.

Enver Hoti – vërejtje është tek prezenca e RTK-së në komision. Është dasht të jetë prezent edhe zyrtari kryesor administrativ. Kemi disa vërejtje, numri i punëtorëve është 701 në RTK. Rregullorja për shpërblime ekziston dhe është në uebfaqen e RTK-së, por nuk ka qasje dhe nuk mund të dihet si aplikohet kjo, kush përfiton shtesa dhe shpërblime? Unë e ndëgjova sqarimin punëtorët me kontrata mbi vepër jemi detyruar me i kthye në punëtorë të rregullt, dhe a ka pas ndonjë procedurë të konkurimit në këtë proces, pasi që kjo nuk ka mundur të ndodhë në mënyrë matematikore? Shofim se shpenzimet për udhëtim dhe shpenzimet tjera keni rritje që për mendimin tim janë të paarsyeshme ngase shifet se është bërë një planifikim i dobët i mjeteve financiare ose një menaxhim i dobët. Vërejtje i kemi shumë të mëdha për RTK-në, sidomos për programet që nuk janë në funksion të publikut. Por ajo që është shqetësuese, cili është numri i kontratave mbi vepër dhe çka ju detyron me i kthye në punëtorë të rregullt dhe a tejkalohet numri prej 701 apo ka edhe të tjerë?

Besa Gaxherri - unë do të fokusohem tek planifikimi i shpenzimeve dhe të hyrave tetor-dhejtor 2016. Ju u keni 2,4 milion nga buxheti i Kosovës të hyra, ndërsa nga marketingu 500,000 euro dhe 50,000 euro të hyra të tjera, që është dasht të specifikohen se për qfarë të hyra bëhet fjalë. Në bazë të të hyrave, ju keni planifikuar me i shpenzue 1,65 milion euro. Për pagat e punëtorëve të rregullt i keni 1.3 milion euro dhe ju po thoni se janë 743 punëtor, kurse për pagat e kontraktuara ende i keni edhe 35,000 euro dhe nuk po sqaroni asnjëherë saktë se punëtorë janë në RTK. Duhet sqaruar pse kontrata kolektive prej 75,000 euro duhet planifikohet si vijë buxhetore, kur ju i keni pagat e kontraktuara dhen i keni pagat e punëtorëve të rregullt. Mëditjet e bordit prej tetorit e deri në dhjetor i keni parashikuar 37,500 euro, plus 300,000 euro shpenzime operacionale të bordit, që për mua janë të papranueshme. Po ashtu duhet sqaruar se qfarë janë shpenzimet e kompanisë në emër të kontributeve dhe shpenzimet e kompanisë në emër të sigurimit?

Gjithashtu është e nevojshme të jepen sqarime për investimet kapitale që për tre muaj i keni planifikuar 237,500 euro. Për web faqe dhe rimbushje të telefonave e keni planifikuar shumën 31,250 euro që për është abnormale. Përveç programeve që i keni mbuluar filmat dhe sportin, për shërbimet kontraktuese dhe korrespondente i keni planifikuar 70,000 euro, qfarë janë këto? Përveç shpenzimeve për Big Bendin, përveç shpenzimeve për skenografi, i keni parashikuar edhe 25,000 euro për programin e Vitit të Ri, për çfarë janë këto shpenzime? Pastaj i kemi shpenzimet e udhëtimit prej 45,000 euro, që nuk krahasohen me asnjë institucion? Për kabruante 15,000 euro ka shumë ankesa që nuk mbulohen shumica komunave me televizionin tuaj, por vetëm në Prishtinë dhe i keni planifikuar gjitha këto shpenzime të kaburantit.

Shipe Pantina – unë me Besën nuk pajtohem shpesh, por në këtë rast pajtohem plotësisht me vërejtjet e ngritura sepse të njëjta qështja, që u thanë janë edhe shqetësime të mija. Nëse analizojmë projektionet, disa herë shpenzimet janë të njëjta por të shpërndara për linja tjera, p.sh, te pagat e punëtorëve të rregullt hyjnë edhe anëtarët e bordit, dhe prap në një linjë tjetër janë planifikuar 37,000 euro ekstra mëditje për bordin, pse i keni ndarë kështu? Çështje tjetër, sa është shuma për paga për punëtorët komplet dhe a futen edhe punëtorët që punojnë në kanal në gjuhën serbe, për të cilin kanal janë parashikuar 295,000 euro. Nëse punëtorët e kanalit të dytë janë punëtorë të rregullt, atëherë pse duhet të ndahen shtesë apo për qfarë janë ndarë 295,000 euro për kanal në dytë?

Kryetari – shuma prej 295,000 euro është për mallra dhe shërbime dhe ky është sqarimi.

Shqipe Pantina – do të duhej me pas një shpejgim narrativ të buxhetit për të parë arasyetimet e shpenzimeve të planifikuara. Sa i përket raportit, unë po i përmendi disa detale si psh. shpenzimet e udhëtimit brenda vendit janë tejkaluar për 11%, pse janë tejkaluar? Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit 109% prap e keni kaluar buxhetin, çka përfshinë, a janë gazetarët që kanë shkuar me i mbulue ngjarjet apo qfarë? Po ashtu shpenzime tjera jashtë vendit, që janë tejkaluar për 16% dhe pse janë dy kategori për të njëjtin qëllim, a janë shpenzimet e bordit që i bëjnë jashtë vendit apo për gazetarët, nuk ka asnjë shpjegim? 20% i keni tejkaluar për përkthime dhe sinkronizime, pse janë

tejkualuar këto shpenzime dhe në bazë të çfarë miratimi? Po ashtu 632 % janë për Lojërat Olimpike dhe kuptojë se është ngjarje e veçantë, por kush e ka miratuar këtë tejkualim? 200% i keni tejkualuar për Kampionatin Evropian të futbollit dhe basketbollit, kush e ka aprovuar një tejkualim të tillë? Furnizimet për zyrë 190%? Ne mund të kuptojmë se ndonjëherë ndodhin situata që duhet bërë lëvizje buxhetore, por duhet me ekzistue disa procedura se ku bëhen këto lëvizje, kush i miraton dhe deri në çfarë mase mund të bëhen tejkualimet? Është dashur të jepen sqarime dhe arsyeime për shpenzime dhe për tejkualimine tyre, dhe ju po kërkonit mjetet dhe nuk po tregoni se si do ti shpenzonit këto para dhe unë nuk mundem me përkrah këtë buxhet.

Kryetari – në mbledhjen e kaluar kur ka raportuar drejtori i përgjithshëm ne kemi marr sqarime të sakta se çka ka ndodhur lidhur me rritjen e shpenzimeve që ka të bëjë me lojërat olimpike dhe kampionatin evropian.

Labinotë Demi – Murtezi – unë dy apo tri herë iu kam bërë pyetje Bordit të RTK-së, pse sjellin disa emisione pako me një çmim të përbashkët dhe në raportin e fundit për gjashtëmujorin, kryetari sipas kërkesës sime ka kërkuar nga ju që të sjellni një raport të detajuar për ato emisione veç e veç, i cili nuk është dërguar dhe tashë është pjesë e këtij raporti. Por tash është prezantuar në formë destruktive, kanë ardhur dy variante të emisioneve të tjera si pako. P.sh te Programi emisionet e brendshme e keni emisionin "Natën", "Bugajski Hour", "Kuizi 123 Fillo", "Kutia Maxhike", "NE", i "Filozofema", "Pa skenar", që nënkupton se vijnë tjera emisione pako. Mandej, e keni titulluar shpenzimin "programi", pa kurrfarë sqarime se për çfarë programi, ndërsa emisionin "Natën" e keni përmendur dy herë? Tek shërbimet e kontraktuara do të duhej me pas sqarim? Është shumë interesante shërbimet e kontraktuara-korrespondentet, si Korrespondenca në Tiranë, SHBA, Bruksel, Beograd, Preshevë, Tetovë, Gjakovë, Prizren, që është shumë çudi brenda Kosovës korrespondentë të veçantë? Pse ditari i Peshkatarit nuk e ka një çmim të veçant, sikurse emisionet tjera? Po shpresojë që në të ardhmen, do ta sjellin një raport më të detalizuar dhe të specifikuar për këto qështje të ngritura.

Bali Muharremaj – po më vjen mirë që sot po pajtohet edhe opozita në qendrimet. Sa i përket raportit financiar nga mënyra se si janë prezantuar shpenzimet, shihet qartë se ka shpenzime enorme dhe ne mendojmë se nuk duhet të lejohen paga marramendëse. Nëse i shikojmë pagat e bordit duken qe janë shumë më të larta se sa pagat e funksionerëve kryesorë të shtetit. Kërkojë në mënyrë publike që të zvogëlohet numri i bordit, për arsye se janë 11 anëtar e shpenzojnë 110,000 euro. RTK po del të jetë njëra nga përbindëshat e buxhetit të Kosovës, nuk po themë që është më i madhi, por mund të futet në zigjirin e shpenzuesve të mëdhenj të Kosovës. Unë themë në mënyrë publike se ky televizion publik dikun 80% i mbron interesat partive që janë në pushtet. Tek qështja e pagave dhe mëditjet u komentua dhe pajtohem me kolegët, por mendoj se duhet edhe njëherë bordi të ulet e të bëjë përmirësime shumë te medha sa i përket këtij televizioni.

Shukri Buja – besojë që keni pas parasysh Ligjin e financave publike rreth bartjes së mjeteve prej një kategori në një kategori tjetër. Por ajo që intereson më shumë është qështja e uljes së tarifave të marketingut, që ju ka krijuar probleme edhe televizioneve private. Ajo që duhet gjithësesi që duhet diskutuar është gjendja katastrofale në objektet e RTK-së që por krijon edhe shpenzime shumë të mëdha, po ashtu edhe kushtet e punës janë katastrofale. Duhet shikuar mundësinë e rritjes vetanake, sidomos nga marketingu, që mos të krijohen shumë shpenzime nga buxheti i Kosovës. Ndërsa, tjetër është lluksi i madh i RTK-së sidomos i udhëtimeve jashtë vendi që po krijojnë shpenzime mjaftë të mëdha. Ndarja e buxhetit prej 10% për kanalin në gjuhën serbe është obligim ligjor, por edhe duhet kontrolluar se si po shpenzohen dhe për çfarë po shpenzohen ato mjete, pasi që nuk i keni pasqyruar në raport. Për udhëtimet jashtë vendit duhet prezantuar pasqyrat e plota, se kush ka shkuar dhe ku kanë shkuar në udhëtime jashtë vendit dhe sa janë krijuar këto shpenzime përkatëse. Duhet ti kemi pasqyrat

për të parë sa po bëhen këto shpenzime jashtë vendit dhe kush i ka bërë ato dhe jo të prezantohen si të përgjithësuara.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se në raportin e ardhshme dhe në raportin vjetor, të paraqiten të detalizuara edhe shpenzimet që janë bërë për kanalin në gjuhën serbe, për të parë mënyrën e planifikimit dhe shpenzimit të atyre mjeteve.

Kryetari – propozojë që komisioni të rekomandojë ministrisë së financave transferin e mjeteve për tremujorin e katërt dhe në të njëjtën kohë të caktojë një grup punues në përbërje: Besa Gaxherri (kryesuese), Labionotë Demi-Murtezi dhe Enver Hoti, që së bashku me menaxhmentin dhe bordin e RTK-së, të bëjnë detalizimin e shpenzimeve për tremujorin e ardhshëm dhe pastaj grupi punues e informon komisionin.

Besa Gaxherri - ju po thoni kryetar se ne duhet shqyrtuar shpenzimet e tremujorit të fundit?

Kryetari – ne po rekomandojmë transferin e mjeteve të RTK-së, kur të kryen punën grupi punues në pastaj votojmë për shpenzimet për tremujorin e ardhshëm. Bordi dhe menaxhmenti i RTK-së, duhet të detalizojë shpenzimet për tremujorin e ardhshëm, i cili i ofrohet grupit punues.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me gjashtë vota Për, tre Abstenime dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomadohet Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 tetor – 31 dhjetor 2016, në shumën prej 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) euro.
2. Caktohet Grupi Punues në këtë përbërje: Besa Gaxherri (kryesuese), Enver Hoti dhe Labionotë Demi- Murtezi. Grupi Punues zhvillon takime me Bordin e RTK-së për analizimin dhe detalizimin e Programit të Shpenzimeve të RTK-së, për periudhën tetor-dhjetor 2016 dhe e informon komisionin për punën e tij.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa dhe amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;

Kryetari – theksoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligjit nr.05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa si dhe amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtim i Raportit me rekomandime te Grupit Punues për Projektligjin Nr.05/L-100 për ndihmën shtetërore

Kryetari – theksoi se grupi punues e ka shqyrtuar projektligjin në dy takime të mbajtura, ku kanë qenë të ftuar dhe prezent zv. ministri i financave dhe përfaqësuesi i ministrisë si dhe kryetari i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Çështje esenciale ka qenë themelimi i Departamenti për Ndihmë Shtetërore. Ka pasur propozime që Zyra për Ndihmën Shtetërore të mbetet në Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Në fund jemi pajtuar që të mbetet Departamenti në kaudër të Ministrisë së Financave, pasi që kërkesa është që pas dy viteve me kalu prapë në këtë Ministri. Nga përfaqësuesit e Ministrisë është arsyetuar se në shumicën e vendeve të BE-së, Departamenti ekziston në kuadër të Ministrisë së Financave. Qështja tjetër është se ne e kemi propozuar shkurtimin e periudhës kalimtare të Komisionit për Ndihmën Shtetërore, sipas nenit 25, deri në fund të vitit 2017, ku kërkohet një periudhë e ngritjes së kapaciteteve në këtë drejtim. Pas kësaj kohet do të zgjidhen ekspertë të pavarur që do ta përbëjnë Komisionin për Ndihmën Shtetërore.

Pas raportimit të kryesuesit të grupit punues dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni, nxori këtë

Rekomandim

- I. Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për Projektligjin nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore.
- II. Raporti me amendamentet procedohet për vlerësim në komisionet tjera të përhershme të Kuvendit.

6. Shqyrtim i Raportit me rekomandime te Grupit Punues per Projektligjin nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168

Kryetari – si grup punues kemi punuar bashkarisht me ministrinë e financave dhe përfaqësuesit e Fondit Pensional. Me amendamentin 6 ne kemi rritur sigurinë ligjore në investimin e mjeteve pensionale në instrumente financiare më të sigurta. Çështje që është diskutuar e që ka të bëjë me mjetet e pa identifikuar pensionale dhe ka pasur propozime të ndryshme, ne kemi ardhur në përfundim se mjete që janë të paidentifikuara, Fondi Pensional nuk mundet me i mbajt në llogari e veta. Por, po ashtu këto mjete të paidentifikuara nuk mund t’iu shpërndahen kontribudhënësve.

Ne kemi konsideruar se i vetmi institucion që mundet me garantu kthimin e mjeteve në rast të identifikimit të kontributdhënësit është Qeveria. Një tjetër çështja që e kemi biseduar është mandati i bordit dhe nuk jemi pranuar që mandati i anëtarëve aktual të vazhdohet për katë vite, por ai të skadojë sipas vendimeve të Kuvendit. Këtë e kemi rregulluar në amendamentin 10, por me qëllim të prezimit të vendimeve të Kuvendit për emërimin e antëtarëve aktual, propozojë që ky amendament të riformulohet, me tekstin “Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, mandati i anëtarëve aktual të Bordit Drejtues vazhdon deri në skadimin e mandatit të tyre të përcaktuar me Vendimin nr. 04-V-840, datë 6 maj 2014 dhe Vendimin nr.05-V-164, datë 30 nëntor 2015, të Kuvendit të Republikës së Kosovës.”

Pas raportimit të kryesuesit të grupit punues dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni, me 6 vota Për, 1 Kundër dhe 2 Abstenime, nxori këtë

Rekomandim

- I. Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për nr. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 04/L-168.
- II. Raporti me amendmentet procedohet për vlerësim në komisionet tjera të përhershme të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në ora 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani